

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6785  
E hënë, 19 dhjetor 2022  
çmimi 0.40

## Gjykata nuk dënoi Saliun, por vetveten

FAQE 3

Muhamet  
MAVRAJ



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KRASNIQI: NË TË KALUARËN KEMI PASUR BARRIKADA, POR I KEMI HEQUR

FAQE 4



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, duke reaguar në lidhje me situatën e tensionuar në veri, ka kërkuar nga qeveria Kurti të mos fshihet pas KFOR-it, por të veprojë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi të Kosovës. "Ne kemi pasur situata të

tilla edhe në të kaluarën, por i kemi hequr barrikadat", ka thënë ai. Lideri i PDK-së ka theksuar se do të ishte dështim i qeverisë Kurti dhe institucioneve udhëheqëse të vendit nëse dorëzohen para kësaj qasje që është krijuar në veri nga bandat kriminale

## AKTUALE



KOREJA VERIORE U RIKTHEHET TESTIMEVE RAKETORE F. 2

PËRURORHET LIBRI "USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS, VLERË KOMBËTARE" F. 6

VAZHDOJNË SUKSESET E KADETËVE E OFICERËVE TË FSK-SË NË AKADEMITË USHTARAKE NË GJERMANI F. 3

## EKONOMI



GJERMANIA HAP TERMINAL PËR GAZ TË LËNGSHËM NATYROR F. 8

BIZNESET NË RREZIK PËR PUNËTORË. IKIN SHOIPTARËT, VIJNË INDIANËT F. 8

## SPORT



ARGJENTINA FITON KUPËN E BOTËS F. 10

## A JANË TË GATSHËM MJEKËT NGA DIASPORA TË PUNOJNË NË KOSOVË?

FAQE 6



DHJETËRA ULTRA-DJATHTISTË SERBË PROTESTUAN AFËR VENDKALIMIT KUFITAR NË JARINJË

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Koreja Veriore u rikthehet testimeve raketore

PHENIAN, 18 DHJETOR - Koreja Veriore ka lëshuar të dielën disa raketa balistike në ujërat lindorë, duke kryer kështu testimet e para këtë muaj. Pheniani ka lëshuar numër rekord të raketave balistike këtë vit më shumë se 60 si dhe ka testuar disa raketa balistike interkontinentale. Ushtria e Koresë Jugore ka identifikuar vëzhgimin e dy raketave verikoreane. Sipas Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë jugkoreane, raketat janë lëshuar me 50 minuta dallim prej njëra-tjetrës, mirëpo nuk ka

dhënë hollësi për llojin e saktë të raketës dhe sa gjatë kanë fluturuar. Mirëpo ushtria jugkoreane kanë thënë se ka zgjeruar spektrin e vëzhgimit dhe është në koordinim të ngushtë me Shtetet e Bashkuara. Zyrtarët japonezë kanë thënë se dy raketa kanë rënë në ujërat mes Gadishullit Korean dhe Japonisë, mirëpo nuk ka raportime për lëndime njerëzore. Ata e kanë kritikuar Korenë Veriore për kërcënim të sigurisë së Japonisë, rajonit dhe

komunitetit ndërkombëtar. Pheniani ka kryer gjashtë testime bërthamore në periudhën 2006-2017 dhe është raportuar se po përgatitet për testimin e shtatë. Këtë vit Koreja Veriore ka miratuar ligjin për shpallje të vetes si shtet me armë bërthamore. Lideri i shtetit, Kim Jong-un, ka hedhur poshtë mundësinë e bisedimeve për çarmatosje. Ky shtet në lindje të Azisë dënon vazhdimisht sanksionet dhe deklaron se sistemi bërthamor i duhet për qëllime të mbrojtjes.



## Angelina Jolie jep dorëheqje nga pozita e ambasadores në UNHCR



GJENEVË, 18 DHJETOR - Aktorja amerikane Angelina Jolie ka thënë se do të japë dorëheqje nga roli i saj si ambasadore për Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR). “Unë besoj në shumë gjëra që bën OKB-ja, sidomos në ruajtjen e jetës përmes ofrimit të ndihmës

urgjente”, ka thënë Jolie, 47-vjeçare. “Unë do të punoj tani me organizata të udhëhequra nga njerëzit, të cilat janë shumë të lidhura me zonat e konflikteve dhe u japin atyre më së shumti zë”. Megjithatë, ajo nuk ka ofruar hollësi se me cilat organizata planifikon të punojë. UNHCR ka thënë se

Jolie ka qenë një prej personave më me ndikim që ka luftuar për të drejtat e refugjatëve. Agjencia ka thënë se aktorja amerikane ka punuar në mbi 60 misione. Muajt e fundit ajo është takuar me njerëzit e zhvendosur si pasojë e luftës në Ukrainë, Jemen dhe Burkina Faso.

## Katari mohon përsëri përfshirjen në rastin e korrupsionit të BE-së

Doha, 18 dhjetor - Katari mohoi përsëri të dielën se është i përfshirë në një rast korrupsioni që po hetohet nga autoritetet belge dhe që përfshin persona të lidhur me Parlamentin Evropian. Autoritetet belge kanë akuzuar katër persona të lidhur me Parlamentin Evropian se kanë marrë para nga organizatori i Kupës së Botës, Katari, për të ndikuar në marrjen e vendimeve në favor të tij. Mes tyre ishte edhe nënkryetarja e parlamentit evropian, deputetja greke Eva Kaili. Ligjvënësit votuan me shumicë

dërrmuese të martën për t'i dhënë fund mandatit të saj në detyrë. Katari ka mohuar më parë të ketë bërë një gjë të tillë. Një diplomat i misionit të Katarit pranë Bashkimit Evropian tha me anë të një deklaratë të dielën se “paragjykimet” kishin ndikuar në vendimin e parlamentit të enjten për ta pezulluar punën mbi legjislacionin që ka lidhje me Katarin dhe për t'i ndaluar përfaqësuesit e Katarit nga ambientet e tij. Pezullimi prek legjislacionin që lidhet me liberalizimin e vizave, një marrëveshje aviacioni BE -

Katar dhe vizitat e planifikuara, derisa akuzat të konfirmohen ose të hidhen poshtë. “Vendimi për një kufizim të tillë diskriminues do të ndikojë negativisht në bashkëpunimin rajonal dhe global të sigurisë si dhe diskutimet e vazhdueshme rreth varfërisë dhe sigurisë globale të energjisë”, tha diplomati. Katari ishte “kritikuar dhe sulmuar ekskluzivisht” në hetim dhe është thellësisht i zhgënjyer që qeveria belge “nuk bëri përpjekje për t'u angazhuar me qeverinë tonë për t'i vërtetuar faktet”, thuhej në deklaratë.



## BE-ja arrin marrëveshje për ta mbrojtur klimën nga gazet karbonikë



BRUKSEL, 18 DHJETOR - Negociatorët e Bashkimit Evropian arritën një marrëveshje politike të dielën për ta ulur çlirimin e gazrave karbonikë dhe për ta ngadalësuar kështu ngrohjen e planetit. Sipas marrëveshjes që do të duhet të miratohet nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli Evropian, BE-ja do të vendosë kosto të reja për karburantin e përdorur për mjetet e transportit dhe ngrohjen e godinave, duke

filluar nga viti 2027. Sipas rregullave të Bashkimit Evropian, centralet dhe fabrikat duhet të “blejnë” licenca për dyoksidin e karbonit që ta vazhdojnë aktivitetin gjatë të cilit prodhohet ndotje. Ky sistem shërben si thelbi i planeve të BE-së për ta ulur ndotjen me 55 % deri në vitin 2030. Sipas marrëveshjes së arritur nga negociatorët e vendet anëtare dhe të Parlamentit Evropian, tregu evropian do të reformohet tashmë duke ulur

nivelin e ndotjes me 62 %. Sipas këtij plani, do të hiqen nga sistemi 90 milionë “licenca” për karbonin në vitin 2024 si dhe 27 milionë të tjera në vitin 2026. Gjithashtu, gjatë periudhës 2026-2034 BE-ja do t'i eliminojë licencat falas që ua jep aktualisht sektorëve industrialë për t'i mbrojtur nga konkurrenca e huaj. Paralelisht, BE-ja do të vendosë një tarifë kufitare për karbonin, që synon t'i mbrojë firmat vendase nga konkurrenca e huaj.

# Gjykata nuk dënoi Saliun, por vetveten

*Për dënimin e Sali Mustafës - Calit*



Muhamet MAVRAJ

Gjykata Speciale në Hagë është parti speciale moti dhe është e jona aq sa ishin policët serbë në uniformën tonë.

Gjykata i ka vënë barrikada drejtësisë, ndaj nuk e ka dënuar Saliun, por vetveten, dënoi besimin në drejtësinë e saj.

Ç'është e vërteta, nuk kemi pritur fare korrektësi prej saj. E dimë si i trajtuan Nasimin e Hysniun, por e kemi parë edhe gjatë seancave kundër Saliut dhe nuk i harrojmë ndërhyrjet e gjyqtarëve me pyetje sugjестive (P.sh. kur një dëshmitar i paguar nuk përmendi frikën, ia kujtoi kjo: A ishte i frikësuar shumë?)

Ajo e dha dënimin, siç e arsyetoi boll mirë, që "bashkësia ndërkombëtare" të kënaqet pas mërzi së gjatë për fenomenin e pandëshkueshmërisë në botë. Ndëshkoni gjetiu, hanem!

Edhe Sali Mustafa është veç kurban, u përdor si "kokë turku" nga kjo Gjykatë. Nuk kemi asnjë detyrim që ta

respektojmë, pavarësisht prej deklaratave koti në përkrahje të dënimin. Politikisht po gabojnë rëndë ata miq perëndimorë që po vazhdojnë të lundrojnë në këtë projekt ruso-serb. Nëse lufta në Ukrainë nuk po ua hap mendjen, çka duhet të ndodhë tjetër me ju gjermanë? Dhe, me ju të tjerët?

Dënimi i Mustafës për krimet që qartazi i kanë kryer serbët dhe shpirtshiturit janë tallje me vlerat e civilizimit, mesazh plotësisht zhgënjyes për çlirimtarët kudo në botë. Këta gjyqtarë dhe shkollën e tyre i kemi parë në EULEX e në UNMIK. Janë faktueshëm mjerimi i drejtësisë.

72 veta vrau një maniak tash vonë në Norvegji dhe mori rreth 20 vjet burg.

Për vrasjen që, siç tha gjyqtarja, e ka kryer ofensiva serbe dhe disa shpulla të supozuara, 26 vjet e dënoi shqiptarin. Qe bota ta shoh se pandëshkueshmëria po goditet!?

Dënimin do ta përbuzja edhe

po të dënohej Saliu me dy orë burg. Mustafa dhe të tjerët shqiptarë në Hagë janë të pafajshëm. Ata janë heronj të gjallë të lirisë dhe fort lirisdashës jo vetëm për kombin e tyre shqiptar, por për çdo komb kudo të shtypur.

Gjykata Speciale është naciste dhe raciste e mirëfilltë. Po i dënon hebrenjtë e ish-Jugosllavisë (shqiptarët që luftuan në tokën e tyre) dhe jo nacistët (serbët pushtues).

Kosova duhet ta ketë programin e vet sqarues me Brukselin dhe të tjerët. Dhe duhet t'i japë fund kësaj gjykate të dëshmtare kokë e këmbë! Vullneti i Kosovës i shprehur me vetëmohim për drejtësi është shpërdoruar tashmë dhe po përdoret qartazi kundër Kosovës dhe të ardhmes së saj. Ndërkohë, gjenocidin serb nuk e përmend kush në botë. Serbia po shpërblehet rregullisht, pra edhe nacizmi në Ballkan dhe Evropë! Nga Evropa!

## Intelektuali danez i bashkohet kërkesës që lulëkuqja të bëhet simbol i gjenocidit në Kosovë



NIELS HENRIK HOOGE

“Unë mbështes iniciativën që institucionet në Kosovë ta përdorin këtë logo si emërtim i përbashkët për spastrimin etnik, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin.”

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Niels Henrik Hooge është një hulumtues shkencor, jurist, filozof dhe shkrimtar danez. Në një postim në rrjetet sociale ai mbështet publikisht kërkesën që lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol unik i përkujtimit të gjenocidit në Kosovë. “Si disa persona të tjerë këtu në Danimarkë, edhe unë mbështes iniciativën që institucionet në Kosovë ta përdorin këtë logo si emërtim i përbashkët për spastrimin etnik, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin që

ndodhi para dhe gjatë fundit të shekullit të kaluar në Kosovë. Ngarjet vazhdojnë të përbëjnë një traumë dhe meritojnë një simbol që kontribuon që ato të mos zhduken nga kujtesa historike”, ishin fjalët e Niels Henrik Hooge.

Në kohën kur Serbia kishte vënë në funksion të gjitha aparatet e dhunës për ta zbatuar politikën e gjenocidit në Kosovë, ky intelektual danez la luksin e Danimarkës, erdhi në Kosovë dhe iu bashkëngjiti luftës çlirimtare të UÇK-së.

## Vazhdojnë sukseset e kadetëve e oficerëve të FSK-së në akademitë ushtarake në Gjermani

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Berlin, me organizim të ambasadorit Faruk Ajeti dhe atashut të Mbrojtjes, nënkolonel Besim Gashi, është mbajtur ceremonia e diplomimit për Agon Berishën i specializuar në IT ushtarake dhe Uran Jahiri i specializuar në logjistikë ushtarake.

Të ftuar të veçantë dhe të pranishëm ishin kolonel Christian Schmidt, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Bundeswehr dhe kapiteni i Forcave Detare, Markus Brueggemeier nga Ministria e Mbrojtjes së Republikës Federale të Gjermanisë të cilët kanë bërë ndarjen e diplomave.

Gjithashtu, në këtë ceremoni ambasadori Ajeti ka përgëzuar oficerin Art Sahiti i cili me sukses ka përfunduar kursin e karrierës për komandant kompanie dhe është graduar në kapiten.

Bashkëpunimi ynë bilateral me Republikën e Gjermanisë është në nivel të shkëlqyeshëm në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.





## Krasniqi: Në të kaluarën kemi pasur barrikada, por i kemi hequr

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, duke reaguar në lidhje me situatën e tensionuar në veri, ka kërkuar nga qeveria Kurti të mos fshihet pas KFOR-it, por të veprojë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi të Kosovës. “Ne kemi pasur situata të tilla edhe në të kaluarën, por i kemi hequr barrikadat”, ka thënë ai. Lideri i PDK-së ka theksuar se do të ishte dështim i qeverisë Kurti dhe institucioneve udhëheqëse të vendit nëse dorëzohen para kësaj qasje që është krijuar në veri nga bandat kriminale

**PRISHTINË, 18 DHJETOR** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, duke reaguar në lidhje me situatën e tensionuar në veri, ka kërkuar nga qeveria Kurti të mos fshihet pas KFOR-it, por të veprojë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi të Kosovës. Në të

kundërtën, sipas Krasniqit, qeveria duhet të deklarohet e paafte për ta qeverisur vendin. Kryetari i PDK-së në një deklaratë për “KosovaPress” ka kërkuar nga qeveria largimin e barrikadave nga veriu sa më parë. Krasniqi duke u shprehur i shqetësuar për rrethanat e

krijua në veri, ka thënë se PDK-ja ka kërkesë të qartë edhe ndaj bashkësisë ndërkombëtare. “PDK-ja ka qenë e qartë në kërkesën dhe ftesën e saj ndaj bashkësisë ndërkombëtare, që t’i denoncojë veprimet antishtet ndaj Kosovës, të kontrolluara dhe të dirigjuara nga Beogradi zyrtar në mënyrë të veçantë kundër bandave kriminale. Kjo do të ishte si hap i parë i nevojshëm në mënyrë që pastaj të ketë një koordinim mes institucioneve të sigurisë së Kosovës dhe KFOR-it për t’i lëvizur këto barrikada. Ne kemi pasur situata të tilla edhe në të kaluarën, por i kemi hequr barrikadat. Qeveria nuk mund të fshihet pas KFOR-it. Qeveria duhet ta zbatojë Kushtetutën dhe ligjet, përndryshe duhet ta

deklarojë paaftësinë e vet për të qenë qeveri e Kosovës”, ka deklaruar Krasniqi. Ai ka theksuar se PDK-ja tash e sa ditë ka kërkuar nga qeveria heqjen e barrikadave. “Ka disa ditë që kemi ftuar Qeverinë e Kosovës që të merret seriozisht me çështjen e barrikadave në veri. Nuk guxon që barrikadat të kthehen në normalitet. Nuk duhet që barrikadat të bëhen pjesë e përditshmërisë, sepse qëllimi i bandave kriminale që i kontrollon presidenti serb Vuçiq që po i shtojnë këto barrikada dita-ditës është që këto të bëhen normaliteti i ri në veri. Do të ishte dështim i qeverisë dhe institucioneve udhëheqëse të vendit tonë nëse dorëzohen para kësaj qasje”, ka thënë ai. Sipas Krasniqit, po të kishte një

insistim më të madh dhe më serioz të qeverisë do të rezultonte me heqjen e barrikadave. “Jam i sigurt që një insistim serioz më i madh i qeverisë dhe i kryeministrit Albin Kurti në raport edhe me partnerët ndërkombëtarë, në radhë të parë me KFOR-in, deri tash do të duhej t’i jepte rezultatet e veta. Ka disa ditë që kanë thënë: ‘Po presim pak’, u bë shumë, mund të bëhet tepër, por një ditë do të jetë vonë. Dhe ne do të vijmë një ditë që s’do të kemi mundësi ta kthejmë normalitetin që e kemi, e atëherë përgjegjësia do të jetë vetëm e qeverisë”, ka thënë Krasniqi. Tash e nëntë ditë janë vendosur barrikadat në veri të vendit dhe janë mbyllur dy pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak.

## Mehaj: Ushtria e Kosovës ka kapacitete moderne luftarake për mbrojtjen e integritetit territorial të vendit

**PRISHTINË, 18 DHJETOR** - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka shpërndarë një video duke thënë se Ushtria e Kosovës ka kapacitete moderne luftarake për mbrojtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit shtetëror të Kosovës. “Ushtria e Republikës së Kosovës me kapacitete

moderne luftarake për mbrojtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit shtetëror të vendit tonë”, ka shkruar Mehaj në “Facebook”. Ministri Mehaj ka shtuar se janë duke vazhduar zhvillimin dhe avancimin e forcave të Kosovës sipas standardeve më të larta të

forcave të vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s. “Për pjesëmarrje efektive në operacione ndërkombëtare të paqes në ndërveprim dhe përkrah forcave aleate të prirë nga ShBA-JA. Detyra, nderi dhe atdheu, mbi të gjitha!”, ka shkruar ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj.



## KFOR-i paralajmëron stërvitje të rregullta në Novosellë

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka bërë me dije se në ditët në vijim do të kryejë stërvitje të rregullta ushtarake afër bazës që ka në Novosellë. Sipas një njoftimi për medie, stërvitjet synojnë t'i trajtojnë njësitet e KFOR-it, për të garantuar lirinë e lëvizjes në kohë krizash dhe "konsistojnë në një seri të simulimeve

taktike dhe aktiviteteve logjistike, përfshirë pajisje të rënda dhe helikopterë". Njoftimi për këto stërvitje vjen në kohën kur autoritetet e Kosovës bëjnë thirrje për heqjen e barrikadave të ngritura nga serbët lokalë në veri të Kosovës.

KFOR-i ka bërë me dije më 16 dhjetor se e ka shtuar numrin e

ekipeve patrulluese në veri. Barrikatat janë ngritur më 10 dhjetor në këtë pjesë të Kosovës si shenjë pakënaqësie ndaj arrestimit të ish-zyrtares serbe të Policisë së Kosovës, Dejan Pantiq.

Pantiq dyshohet se ka organizuar "sulm terrorist" në zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri të Kosovës

më herët gjatë muajit dhjetor. Komunitatet veriore - Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq - janë të banuara me shumicë serbe.

Derisa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se pret që KFOR-i t'i largojë këto barrikada, i dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar,

ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se pret që barrikatat të hiqen nga personat që i kanë ngritur ato.

Së fundi, autoritetet serbe i kanë dërguar kërkesë KFOR-it për angazhimin e deri në 1 000 pjesëtarëve serbë të sigurisë në Kosovë, duke u thirrur në Rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara.



## Dhjetëra ultra-djathtistë serbë protestuan afër vendkalimit kufitar në Jarinjë

MITROVICË, 18 DHJETOR - Dhjetëra ultra-djathtistë serbë u mbledhën pasditen e së dielës në anën serbe të vendkalimit kufitar, Jarinjë, që ndan Kosovën dhe Serbinë, për të shprehur, siç thanë, mbështetje për popullin serb në Kosovë. Protesta u përshkua me incidente, pasi protestuesit bënë përpjekje ta thyejnë kordonin policor.

Në anën serbe afër Jarinjës - pikëkalimit kufitar mes Kosovës dhe Serbisë - ka mbaruar një protestë e thirrur nga grupe djathtiste serbe si shenjë mbështetjeje ndaj barrikadave që kanë ngritur serbët lokalë në veri të Kosovës.

Protestuesit janë shpërndarë pasi policia serbe u ka thënë se do të lirojë një person që ka arrestuar në protestë.

Organizatorët e protestës kanë thënë se serbët në veri të Kosovës janë "nën presion të madh" dhe që e kanë pasur të ndaluar që t'i

bashkohen protestës së 18 dhjetorit.

Kur e kanë përmendur presionin, ata kanë kritikuar Listën Serbe - partinë më të madhe të serbëve në Kosovë. "Kemi dashur të shkojmë te KFOR-i, atje do të na ishin bashkëngjitur edhe disa persona të tjerë, për t'i treguar KFOR-it që të largohet nga këtu, sepse nuk ka çfarë kërkon".

Pjesëtarë amerikanë të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, janë parë në anën e Kosovës, te pikëkalimi në Jarinjë. "Kjo është toka jonë dhe nuk pajtohem me këto kalime administrative", ka thënë Damjan Knezheviq, kreu i grupit jozyrtar të ekstremit të djathtë "Patrulla Kombëtare" nga Serbia.

Barrikatat janë ngritur më 10 dhjetor në këtë pjesë të Kosovës si shenjë pakënaqësie ndaj arrestimit të ish-zyrtares serbe të Policisë së Kosovës, Dejan Pantiq.



# Përrurohet libri “Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare”

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 18 DHJETOR** - Përrurimi i librit “Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare” mbledhi përreth vetes në Prishtinë drejtues të institucioneve, publicistë, shkrimtarë, studiues, veteranë, invalidë e gazetarë.

Përrurimi i librit është bërë nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë dhe Institutin Albanologjik të Kosovës.

Në hapjen e këtij përrurimi fillimisht foli drejtori ekzekutiv i AShAK-së, Bedri Zyberaj, i cili zbuloi më shumë mbi rrethanat dhe shtysat e këtij publikimi. “Ky libër është fryt jo i një individi, por i një numri të konsiderueshëm studiuesish të historisë dhe të kulturës sonë.

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk po i ndahen sfidat edhe pas shuarjes së saj. Ideja për organizimin e një sesioni shkencor ka qenë që prej vitit 2020, kur u bënë publike aktakuzat kundrejt drejtuesve të UÇK-së, por një sesion i tillë nuk u mbajt për shkak të masave kufizuese të pandemisë”, ka thënë Zyberaj. Në përrurimin e këtij libri morën fjalën edhe dekan i Fakultetit të Shkencave Shoqërore Bashkëkohore të Universitetit të Evropës Juglindore - Tetovë, Abdulla Azizi dhe publicisti Muhamet Mavraj, të cilët folën mbi publikimin që ka parë së fundmi dritën e botimit, duke theksuar në ligjërimin e tyre epopenë dhe rëndësinë e përveçme të UÇK-së në përpjekjet çlirimtare të shqiptarëve të Kosovës. “Botimi të cilën e keni në duar paraqet




një kontribut të rëndësishëm akademik për audiencën kosovare dhe më gjerë. Autorët këtu bëjnë një analizë të thelluar të veprimtarisë së UÇK-së, nxjerrin konkluzat me bazë shkencore për retrospektiven historike të ngjarjeve dhe ndodhive reale, duke përgenjështuar të pavërtetat dhe trillimet për zbehjen e idealit kombëtar të UÇK-së. Rëndësia e këtij botimi del në pah duke parë vëmendjen në rritje që po i kushtohet aktivitetit shtetformues të UÇK-së në etablimin e një shteti sovran si subjekt i barabartë në komunitetin ndërkombëtar

dhe në marrëdhëniet me vendet e tjera. Ky tekst bëhet i rëndësishëm si në kuadrin e një vlere të shtuar për historinë e shtetformimit të Kosovës, po ashtu edhe në studimet e bashkëkohore në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe sigurinë ndërkombëtare në mjedisin akademik shqiptar”, ka thënë Azizi.

Në fjalën përmblyëse të përrurimit të librit ka folur edhe drejtori i Përgjithshëm i Arkivave të Shqipërisë, Ardit Bido, duke nënvizuar rëndësinë e një produkti shkencor të këtij lloji, që duhet të shërbejë si një mësim për të ardhmen. “Është detyrë dhe kënaqësi që të jemi

së bashku në rrethanat të tilla për të prodhuar produkt shkencor jo thjesht për të kaluarën, por për të parë të ardhmen përmes së kaluarës, sepse fusha e historisë dhe e shkencave humane në përgjithësi por edhe çdo shkencë tjetër ekziston, në mënyrë që e ardhmja të jetë më e mirë. Dua t’i falënderoj bashkorganizatorët dhe do ta veçoj Bedriun sepse e kuptoj se pse nuk u zgjat për të treguar se çfarë është bërë për të arritur në një deklaratë të përbashkët, për të dhënë një ton brenda vijës shumë të hollë të shkencës dhe njëherazi të qartë”, u shpreh Bido.



## A janë të gatshëm mjekët nga diaspora të punojnë në Kosovë?

**Prishtinë, 18 dhjetor** - Disa mjekë me prejardhje nga Kosova, që punojnë jashtë shtetit, nuk janë të interesuar për punë në Kosovë, edhe pse kanë marrë ftesë nga Ministria e Shëndetësisë.

Lekë Abdyli, hematolog në një spital në Grac të Austrisë, thotë shkurtimisht për REL-in se nuk do ta ushtronte profesionin e tij në Kosovë.

“Janë shumë arsye, infrastruktura e mjekësisë që është zero, pastaj pagesa dhe përfitimet e tjera”, thotë ai.

Ai nuk tregon se sa paguhet për punën që bën, por në Kosovë paga bruto e një mjeku është 630 euro.

As Shaip Ibishi, specialist i gjinekologjisë në Gëtingen të Gjermanisë, nuk është i mendimit për t’u angazhuar në Kosovë. “Nuk është në pyetje vetëm paga, por janë edhe kushtet e punës [në Gjermani], mundësia që ofrohet në mjekësi moderne, investimet në aparaturë, teknologji etj”, thotë Ibishi, i cili ka vite që punon në shtetin e Evropës

perëndimore.

Muajin e kaluar Ministria e Shëndetësisë e Kosovës u ka bërë thirrje profesionistëve të fushave të ndryshme mjekësore në mesin e mërgatës shqiptare për angazhim dhe punë në institucionet shëndetësore publike të Kosovës. Ajo nuk ka dhënë ndonjë arsye apo informacion se në çfarë mënyre apo kushtesh do të angazhoheshin ata. Nuk ka treguar as cilat profile të mjekëve i kërkon.

Në një deklaratë për “Radion Evropa e Lirë” nga kjo ministri thonë se “aspektet që ndërlidhen me pagën dhe çështje të tjera do të diskutohen në proces e sipër”.

Sipas tyre, thirrja është bërë për të gjitha fushat e shëndetësisë, por me theks të veçantë në fushat deficitare. “Fusha deficitare në këtë sistem janë: kardiokirurgjia, mjekimi intensiv, anesteziologjia (ka kuadër, mirëpo nevojat janë më të mëdha), kardiokirurgjia e fëmijëve etj”, thuhet në deklaratë.



Kosova prej vitesh përballat me mungesë mjekësh.

Vetëm gjatë këtij viti 200 mjekë të profileve të ndryshme kanë braktisur sistemin shëndetësor dhe kanë emigruar kryesisht drejt vendeve të Bashkimit

Evropian, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë”, Pleurat Sejdiu, kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës.

Nga Ministria e Shëndetësisë thonë se thirrjes së tyre i është përgjigjur “një numër solid i

mjekëve dhe profesionistëve shëndetësorë” nga diaspora, por nuk specifikojnë më shumë. “Disa nga ta janë profesionistë që punojnë në institucione mjaft kredibile ndërkombëtare”, thonë ata.

## Gjermania hap terminal për gaz të lëngshëm natyror

**BERLIN, 18 DHJETOR** - Kancelari gjerman Olaf Scholz e ka hapur terminalin e parë të gazit të lëngshëm natyror në qytezën veriore VilhelmsHAVEN. Ndërtimi i tij në afat rekord prej më pak se 10 muajve tregon "kapacitetin e shtetit tonë për fillime të reja", ka thënë ai në ceremoninë inauguruese. Ky terminal është ndërtuar për të ndihmuar në zëvendësimin e gazit rus. Terminali në të ardhmen pritet ta shndërrojë gazin e

lëngshëm natyror në gjendje gazi ashtu që të përdoret nga rrjeti gjerman i energjisë. Vitin e ardhshëm pritet të ndërtohen edhe katër terminale të tjera të tilla në Gjermani. Sipas Ministrisë së Ekonomisë së Gjermanisë, të gjitha këto terminale së bashku mund të sigurojnë një të tretën e gazit që i duhet Gjermanisë. Scholz e ka marrë vendimin për ndërtim të terminaleve tri ditë pas nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë.

Si pasojë e sanksioneve që i ka vënë Perëndimi Moskës për këtë luftë, Rusia i ka zvogëluar furnizimet me gaz në Evropë dhe, me raste, i ka ndaluar ato tërësisht. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



## Reçica akuzon ministrin e Financave për dështimin e impiantit në Ferizaj

**PRISHTINË, 18 DHJETOR** - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) vlerëson se buxheti i vitit 2023 i miratuar dy ditë më parë në Kuvend është jozhvillimor dhe diskriminues.

Deputeti nga kjo parti, Elmi Reçica, përveç që ka pasur kritika për buxhetin, ka akuzuar ministrin e Financave, Hekuran Murati, për ndarje jo të drejtë buxhetore dhe dështimin e një projekti për rajonin e Ferizajt. Deputeti Reçica, një në një intervistë për "KosovaPress", ka thënë se ministri Murati qëllimisht e ka dështuar një marrëveshje ndërkombëtare me Hungarinë për financimin e projektit për trajtimin e ujërave të zeza në Ferizaj.

Mes dy leximeve, PDK-ja propozoi 37 amendamente për buxhetin 2023, një prej tyre edhe për ndarjen e mjeteve për impiantin e Ferizajt, por që asnjë prej këtyre amendamenteve nuk ka kaluar gjatë shqyrtimit në seancën e fundit. "Unë kam pasur 6 amendamente, edhe një për komunën e Vitisë, që është më i diskriminuar. Në amendamentin 14 kam parashtruar një nevojë të domosdoshme në formë të



amendamentit për një impiant për trajtimin e ujërave të zeza. Është rajoni i Ferizajt një nga shtatë regionet që është tatimpaguesi i dytë në Kosovë pas komunës së Prishtinës dhe nuk ka asnjë impiant për

trajtimin e ujërave të zeza. Për këtë kam kërkuar që të ndahen mjete buxhetore meqë ato mjete inkasohen nga komuna e Ferizajt përmes taksave dhe tatimeve dhe kontributeve të tjera, të ndahen 42 milionë euro.

Dhe duke pasur parasysh që ne kemi pasur një marrëveshje me qeverinë hungareze në vlerë prej 62 milionë eurosh, marrëveshje e cila brenda saj ka pasur edhe impiantin për trajtimin e ujërave të zeza, dhe

kjo qeveri dhe ky ministër, Hekuran Murati, qëllimisht e ka dështuar këtë marrëveshje vetëm për arsye politike. Ai ka edhe përgjegjësi personale për shkak të dështimit të asaj marrëveshje", ka thënë Reçica.

## Bizneset në rrezik për punëtorë. Ikin shqiptarët, vijnë indianët

**TIRANË, 18 DHJETOR** - Largimi i të rinjve drejt vendeve të BE-së për një jetë të mirë ka vendosur në vështirësi bizneset në Shqipëri. Pashko Smaçi prej shtatë vjetësh drejton një fabrikë tullash në qytetin e Lezhës. Ai thotë se, përveç krizës, makineritë po qëndrojnë të fikura pasi mungojnë specialistët që t'i vendosin ato në punë. Mungesa e fuqisë punëtore rrezikon që ta falimentojë biznesin 30-vjeçar të tullave. Dëshir Gjetja, ndryshe nga Pashko, ka vepruar më shpejt për ta zëvendësuar fuqinë

punëtore. Në fabrikën e konstruksioneve metalike të Lezhës si fillim ai ka punësuar 10 shtetas indianë. Ai thotë që nuk ishte dëshira e tij që t'i punësonte indianet, por që nevoja ajo që e hodhi në tregun e punëtorëve ndërkombëtarë. "Kemi marrë punëtorë të huaj që nga janari, pasi pati një fluks të largimit të punëtorëve në vendet evropiane. Ne kemi marrë 10 indianë punëtorë. Ka premisa që do të shtojmë edhe indianë edhe shqiptarë. I mirëpresim që të mos na ikin. Ata e kanë vendin e parë në punë", është

shprehur Dërshir Gjetja. Harkisha Sing afërsisht ka një vit që punon në Shqipëri. Sipas tij, Shqipëria së shpejti mund të bëhet atdheu i dytë familjes së tij. "Këtu është punë e mirë. Ndoshta do t'punojë për një kohë të gjatë. Ndoshta pas disa kohësh sjell edhe familjen time nga India në Shqipëri. Po përpiqem të ambientohem. Më shumë se ushqimi, më pëlqejnë ëmbëlsirat", ka thënë Harkisha Sing. Shumë punëtorë nga Nepali, Indian, apo Bangladeshi punësimin në Shqipëri e kanë përdorur si trampolinë për të



shkuar në shtet e Evropës. Por përballë mungesës së fuqisë punëtore, Dëshiri thotë se

marrja e punësimit të huajve është e keqja më e vogël kur mendon mbylljen e fabrikës.

# Ushtria Çlirimtare e Kosovës si domosdoshmëri e kohës

**MA Emin SALLAHU**

Përpjekja e popullit shqiptar për liri ka qenë e gjatë dhe e pandalshme. Kjo përpjekje u shtua në shekullin XX. Robëria e gjatë nën pushtuesin Osman u zëvendësua me pushtues të ri – Serbinë. Pas rënies së Perandorisë Osmane në fillim të shekullit XX dhe ndryshimit të forcave në terren, apetitet e fqinjëve, sidomos Serbisë, u rritën në drejtim të pushtimit të trojeve shqiptare të cilat tashmë ishin pa një mbrojtje të organizuar. Megjithatë, angazhimin shqiptarët e realizuan edhe në kuadër të garnizoneve turke në luftën kundër sulmeve të ushtrisë serbe. Gjendja e popullit shqiptar u keqësua pas konferencës së Ambasadorëve në Londër, e cila la jashtë Shqipërisë shumë troje shqiptare të cilat u bënë pre e fqinjëve, sidomos Serbisë. Rezistenca e shqiptarëve ishte e vërtetë, si kryengritja e Dibrës më 1913 e udhëhequr nga Elez Isufi, pastaj zgjerimi i forcave në drejtim të Gjakovës, Prizrenit e Dukagjinit të udhëhequra nga Bajram Curri dhe Isa Boletini zhvilluan luftime të ashpra me ushtrinë serbe, e cila u detyrua të mobilizojë forca shtesë.[1] Në vazhden e rezistencës hyn edhe lëvizja kaçake e udhëhequr nga Azem Bejta i cili nga ana e Komitetit për Mbrojtje Kombëtare të Kosovës ishte emëruar udhëheqës i rezistencës. Populli shqiptar iu nënshtrua dhunës dhe terrorit sistematik në të gjitha sferat e jetës, që nga prona duke uzurpuar tokat e tyre dhe duke ua dhënë kolonëve të sjellë nga viset e ndryshme të Serbisë dhe Malit të Zi, të drejtat për shkollim iu mohuan, gjendja socio-ekonomike ishte shumë e rënduar, ndërsa përpjekjet për çlirim ishin kryesisht të karakterit lokal dhe rajonal, por të cilat në vazhdimësi shuheshin me gjak. Populli shqiptar kaloi nëpër katrahura si në luftërat ballkanike, po ashtu edhe gjatë LPB-së. LDB e gjeti popullin shqiptar në gjendje shumë të vështirë. Shqiptarët jashtë Shqipërisë Londineze ishin të paorganizuar dhe të rezikuar nga shfarosja edhe pse bashkëngjitja e tyre në LNÇ u realizua me shpresë për t'i fituar të drejtat që i takonin fatkeqësisht nuk ndodhi gjë që u dëshmuar gjatë edhe pas LDB-së. Fati i popullit shqiptar në Kosovë ishte tragjik sepse në njërin anë u rreshtuan në krah të brigadave partizane të LNÇ-së, ndërsa disa brigada partizane jugosllave (serbo-malazeze) ndaj popullatës shqiptare kryenin vrasje dhe persekutime. Vlen të theksohet, p.sh., gjatë vitit 1943 vetëm në Sanxhak janë realizuar nga qetat çetnike dy sulme ndaj popullatës shqiptare. Korpusi i dytë i UNÇJ-së luftoi pa mëshirë shqiptarët të cilët u dolën në ndihmë vëllezërve të tyre në Sanxhak nga sulmet çetnike dhe çetniko-partizane.[2] Rezistenca e shqiptarëve në

Kosovë gjatë LDB-së u nda në dysh, në njërin anë bashkëngjitja në UNÇJ, në anën tjetër në forcat e rezistencës ndaj krimeve që pikërisht kjo ushtri kryente mbi popullatën e pambrojtur shqiptare. Në krye të Brigadës së Drenicës qëndronte Shaban Polluzha i cili, pas mobilizimit dhe urdhërësës që Brigada e ashtuquajtur "Kosmeti" në fillim të janarit të vitit 1945 të dërgohet në frontin e Sremit, gjë që u refuzua nga Shaban Polluzha, me qëllim që t'i dalë në mbrojtje populli nga masakrat e mëtejme të brigadave çetniko-partizane. Pas refuzimit filluan operacionet për likuidimin e brigadës së tij. Në shkurt (21.02.1945) u vra edhe vetë Shaban Polluzha, Mehmet Gradica etj. dhe u shua kryengritja ose rezistenca e shqiptarëve.

Pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë u vendos regjimi dhe administrata ushtarake e cila popullatën shqiptare vazhdoi ta trajtojë në formë brutale. U mbajtën gjykime ushtarake duke i dënuar, por edhe ndjekur ata që nuk pajtoheshin me regjimin. Ndaj shqiptarëve u ushtrua dhunë edhe gjatë aksionit për mbledhjen e armëve në vitin 1955-1956. Këto aksione ishin me qëllim të frikësimit dhe dëbimit të shqiptarëve për Turqi. Rrethanat të cilat e lanë popullin shqiptar të ndarë në disa, republika dhe krahina në federatë janë të njohura. Shqiptarët vazhduan organizimin në lëvizje ilegale pas së cilës nga ana e pushtetit jugosllav pasuan arrestime, burgosje dhe ndjekje të veprimtarëve të shumtë e ndër të cilët ishte edhe simboli i rezistencës Adem Demaçi, Fazli Grajçevci, Metush Krasniqi e shumë veprimtarë të tjerë. Në vitin 1968 shpërthyen demonstrata masive kundër padrejtësive duke kërkuar të drejta brenda federatës si dhe shkollimin dhe përdorimin e flamurit kombëtar shqiptar, duke detyruar pushtetin e Titos t'i lirojë masat dhe ta fillojë aplikimin e të drejtave më të avancuara si hapjen e universitetit dhe me ngritjen e Kosovës në Krahinë Autonome në kuadër të Federatës Jugosllave në vitin 1974. Në vitin 1981 shpërthyen demonstratat masive me kërkesën kryesore statusin e Republikës në Federatën Jugosllave. Veprimet ishin të menjëshërshme nga ana e pushtetit duke i shtypur demonstratat në mënyrë të përgjakshme dhe duke kryer arrestimet dhe gjykimet politike me dënime të mëdha ndaj të rinjve dhe të rejave shqiptarë. Veprimtarët brenda dhe në mërgatë ndiqeshin dhe vriteshin si, p.sh., vëllezërit Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. Represioni dhe dënimet nuk e dekurajuan rininë dhe popullin shqiptar, përkundrazi vazhdoi rezistenca për liri dhe sa shkonte koha edhe kërkesat rriteshin dhe organizimi forcohej. Në fillim të viteve '90, pas ardhjes në pushtet të Slobodan Millosheviqit, i cili kishte rrënuar autonominë e Kosovës më 1989 dhe praktikisht e kishte



ripushtuar Kosovën, shqiptarët u organizuan duke formuar institucionet paralele për t'iu kundërvënë Serbisë. Janë të njohura organizimet e arsimit shqip paralel nëpër shtëpi private, hapja e ordinancave mjekësore (kryesisht përmes Shoqatës "Nëna Terezë") zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe forma të ndryshme përmes lëvizjes pacifiste kryesisht në kuadër të LDK-së e cila ishte partia kryesore e shqiptarëve të Kosovës të cilën e udhëhiqte dr. Ibrahim Rugova. Në fillim të viteve '90shpërtheu lufta në Slloveni, Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë dhe Federata Jugosllave tashmë po zhbëhej, situatë kjo e cila shqiptarët e Kosovës i gjeti të papërgatitur për ta filluar luftën ndaj Serbisë. Lëvizja pacifiste me kalimin e kohës filloi ta humbë efektin mobilizues te popullata si rezultat i veprimeve represive serbe të cilat reflektoheshin me ndjekje, arrestime, vrasje dhe largim nga puna e cila pasoi me largimin e një numri të madh të shqiptarëve për në Perëndim. Pas një situatë të tillë populli filloi të humbasë durimin dhe besimin në ndjekjen e një forme pasive të rezistencës. Tanimë ishin pjekur kushtet për një rezistencë aktive së cilës i kishin paraprirë veprimtarë dhe grupe të organizuara ilegale të armatosura si, p.sh., "Çeta e Llapit" e prirë nga Ali Ajeti (tani hero i kombit) 1989, pastaj Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës LKÇK, organizatë politiko-ushtarake e cila kishte edhe njësitin gueril "Rexhep Mala" me komandant Agron Rrahmani (tani hero i kombit), pastaj Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) nga e cila edhe lindi Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Qysh në fillim të vitit '91 veprimtarë dhe atdhetarë nga Kosova dhe mërgimtarë të ardhur nga Perëndimi në krye me Adem Jasharin i cili krijoi Grupin e Drenicës filluan stërvitjet ushtarake për një luftë guerile, dhe në vitin 1992 realizuan aksionet e para kundër forcave policore serbe. Më 05.04.1993, në kullën e tij në Prekaz, Adem Jashari së bashku me shokë vendosën që të gjitha aksionet kundër forcave policore ushtarake serbe të kryheshin në emrin e UÇK-së. Aty u vendos që Adem Jashari do të jetë komandanti kryesor i ushtrisë e cila në vjeshtën e vitit 1994 e mori emrin UÇK. Publikisht UÇK-ja doli më 28 nëntor 1997 pas vrasjes së mësuesit në Llaushë të

Skenderajt, Halit Geci. Përfaqësuesit e parë që dolën publikisht ishin Rexhep Selimi, Daut Haradinaj dhe Mujë Krasniqi (tani hero i kombit). Dalja e UÇK-së në publik mobilizoi dhe forcoi shqiptarët anekënd botës. Kjo ngjarje pa dyshim historike bëri që të forcohet bindja se tanimë rruga e vetme ishte lufta e armatosur. Forcat policore ushtarake serbe u munduan ta shuajnë kryengritjen e armatosur të shqiptarëve, sepse tani situata filloi t'u dilte nga kontrolli. Aksionet për luftimin e pjesëtarëve të UÇK-së vazhduan dhe në mars të vitit 1998 pas rezistencës heroike të komandantit Adem Jashari me familje, e cila përfundoi me vrasjen e tij, të familjes dhe të afërmeve që morën pjesë në luftime me forcat policore-ushtarake serbe, ndodhi kthesa e madhe. Mobilizimi dhe shtimi i UÇK-së mori përmasa gjithëpërfshirëse dhe të paparë deri më tani. Mërgata u mobilizua dhe filloi grumbullimin e ndihmave të të gjitha llojeve, në veçanti furnizimi me armatim nga brenda dhe jashtë Kosovës mundësoi edhe plotësimin e radhëve me ushtarë të cilët vinin nga të gjitha trojet shqiptare dhe diaspora. Rol vendimtar për përgatitjen e luftës çlirimtare kishte shteti amë, Shqipëria, e cila ndihmoi në të gjitha aspektet si në ushtrime ushtarake me kuadro dhe logjistikë, pastaj rrugëtimi i armatimit dhe luftëtarëve kishte për bazë territorin e Shqipërisë. Zgjerimi dhe shtrirja e UÇK-së ndodhi në pothuajse tërë territorin e Kosovës dhe kjo pa dyshim paraqet arritjen kulmore të organizimit duke kaluar të gjitha përfshirjet e mëhershme mobilizuese ushtarake nga ana e shqiptarëve të Kosovës. Këto aktivitete ushtarake rezultuan edhe me marrjen e disa territoreve nën kontroll duke u shtirë në aspektin operativ në disa zona (shtatë sish). UÇK-ja mori rolin prirës në luftën e armatosur edhe atë politike për çlirimin e Kosovës. Tanimë UÇK-ja shtriu rrjetin me një strukturë si në vijim: Shtabi i Përgjithshëm dhe shtatë Zona. Zona Operative e Drenicës, Zona Operative e Pashtrikut, Zona Operative e Dukagjinit, Zona Operative e Shalës, Zona Operative e Llapit, Zona Operative e Nerodimes dhe Zona Operative e Karadakut.

Mobilizimi i popullit shqiptar rreth UÇK-së bëri që edhe bashkësia ndërkombëtare ta trajtojë ndryshe Kosovën dhe kërkesat e popullit të saj. Filluan kontaktet edhe me përfaqësuesit e Shtabit të Përgjithshëm të cilët e kishin edhe drejtorinë politike të saj të cilën e udhëhiqte Hashim Thaçi, u hap zyra e UÇK-së në Prishtinë me përfaqësues simbolin e rezistencës Adem Demaçin. Bashkësia ndërkombëtare në fillim hezitoi t'i kontaktonte guerilët, por ishte përfaqësuesi amerikan Richard Holbruk ai që i takoi përfaqësuesit e UÇK-së në Junik (qershor 1998), duke paralajmëruar përkrahjen e ShBA-së për luftën e drejtë çlirimtare të popullit shqiptar të udhëhequr nga UÇK-ja. Pas ShBA-së vazhdoi edhe Evropa të përafrohej duke rezultuar edhe me organizimin e Konferencës së Rambujesë duke e ngritur në nivelin më të lartë përfaqësues UÇK-në përmes përfaqësuesve të saj në krye me Hashim Thaçin si dhe përfaqësuesit e krerëve politikë të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, akademik Rexhep Qosja etj. Pas kësaj konference, e cila rezultoi pa sukses, sepse pala serbe nuk pranoi kushtet e vëna nga bashkësia ndërkombëtare dhe si rezultat i kësaj pasoi intervenimi i forcave të NATO-s në mars të vitit 1999 dhe se kjo padyshim paraqet suksesin më të madh dhe kthesën drejt çlirimit përfundimtar të Kosovës në qershor të 1999-s. Lufta e drejtë e UÇK-së paraqet organizimin më gjithëpërfshirës ushtarak dhe mobilizimin më të madh të shqiptarëve të Kosovës, por edhe përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare të organizuar ndonjëherë deri më tani, si dhe përcjell për gjeneratat që vijnë mesazhin se për t'u çliruar nga pushtuesi duhet gjithsesi për të luftuar. Lindja e UÇK-së ishte domosdoshmëri e kohës dhe se kjo ushtri e lavdishme besoj se do ta ketë vendin meritore në historinë e popullit shqiptar si një nga organizimet më të suksesshme të luftës çlirimtare për realizimin e aspiratave shekullore të popullit shqiptar për liri.

(Marrë nga libri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare", botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kjo kumtesë është paraqitur në sesionin shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022, organizuar nga: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kumtesat e njëzet intelektualëve shqiptarë gazeta "Epoka e re", përpos në portal, do t'i botojë për njëzet ditë me radhë edhe në formatin pdf. Librin mund ta gjeni në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.)

[1] Liman Rushiti, Gjenocidi dhe aktet gjenocidiale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga kriza lindore e këndeje, Prishtinë, 1995, f.87-97.

[2] Po aty f. 171.



# Drejtësia dhe pastërtia e luftës së UÇK-së



Më mirë flakë e gjak, se armiku në prak”  
(Popullore)

“Trimëri e vërtetë është ajo që vihet në shërbim të së drejtës dhe atdheut. Të tjerat janë egërsi”: (Faik Konica)

Nga Adil FETAHU

## Lufta e UÇK-së ishte e drejtë

Në doktrinën e luftërave ka teori, parime, kritere dhe elemente të ndryshme, sipas të cilave përcaktohet karakteri i një lufte, se a është luftë e drejtë apo jo. Këto teori kanë të bëjnë kryesisht me luftërat midis shteteve, por kohëve të fundit janë zgjeruar edhe për luftërat (konfliktet e armatosur) që zhvillohen brenda shteteve. Termi konflikti i armatosur është më i përshtatshëm për t'u përdorur, sepse është nocion më i gjërë, që përfshinë edhe luftërat klasike midis shteteve, edhe luftën e grupeve brënda shtetit. Prandaj, edhe për luftën e UÇK-së kundër forcave serbe gjithnjë e më tepër po përdoret kjo terminologji. Kjo nuk ka të bëjë me nënçmimin e luftës së UÇK-së, siç mendojnë disa, por ka të bëjë me përdorimin e një terminologjie të re të pranuar në doktrinën e luftërave. Por, për shkak të terminologjisë më të pranueshëm në Kosovë kur bëhet fjalë për konfliktin e armatosur me forcat serbe, edhe ne këtu do ta përdorim termin: luftë (lufta e UÇK-së). Për vlerësimin dhe përcaktimin

se a është një luftë e drejtë nga pikëpamja juridike, humanitare dhe morale, duhet të merrën parasysh disa faktorë dhe elemente. Në rend të parë vijnë shkaqet që shkaktojnë luftën. Pastaj është kauza që synohet të arrihet me luftë. Janë përpjekjet e bëra paraprakisht, që në rrugë paqësore të arrihet një qëllim i drejtë pa u përleshë me luftë. Lufta të jetë opsion i fundit, pas dështimit të të gjitha përpjekjeve paqësore për arritjen e qëllimit. Është e drejta e popujve për të vendosur për fatin e vet, për çlirim nga një regjim jolegjitim, për vetëvendosje për statusin e vet politik dhe për zhvillim shoqëror dhe ekonomik, duke i shfrytëzuar resurset e veta njerëzore dhe natyrore. Në rastin e luftës së UÇK-së kundër regjimit dhe forcave okupuese të Serbisë, janë përmbushur të gjitha këto kushte, elemente dhe kritere. Prandaj, lufta e UÇK-së është plotësisht e drejtë në pikëpamje të doktrinës juridike për luftën. Së pari, Kosova ishte e okuar nga Serbia qysh prej vitit 1912 dhe e aneksuar me dhunë shtetit të Serbisë. Këtë aneksim e lejoi Konferenca e Londrës (1913), e pas çlirimit të Kosovës (1999), duke folur për sulmet e NATO-s, kundër forcave serbe, ish-sekretari i

jashtëm i Britanisë së Madhe, (tash i ndjeri) Robin Kuk, pa thënë: “I kam lexuar të gjitha dokumentet e asaj Konference. Atë padrejtësi që është bërë atëherë, po e ndreqim tash”.

Nën regjimin e Serbisë e të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene (1912 -1941), populli shqiptarë i ishte ekspozuar padrejtësisë, diskriminimit dhe terrorit në baza nacionale, fetare, sociale, ekonomike, kulturore e në çdo bazë tjetër.

Se çfarë qëndrimi kishte shteti serb kundër shqiptarëve mund të ilustronim me disa theksime nga Platforma e akademikut e ministrit serb, Vasa Çubrilloviq, kur e arsyetonte programin e tij për shpërnguljen e Shqiptarëve; ai thotë: “Ne Serbët nuk kemi armiqë më të mëdhenj se Shqiptarët. Nëse duhet ta ngrejme kokën tonë, duhet ta ulim kokën e tyre; nëse duhet të ndjehemi gjërësisht në hapësirë, duhet t’ua ngushtojmë hapësirën e tyre; nëse duhet të na dojë bota neve, duhet të bëjmë çmos që t’iurrejë ata.

Që Iliro-Dardanët ta braktisin vendin e tyre, duhet me çdo kusht dhe me çdo mënyrë t’ua nxijmë jetën. Që të arrijmë këtë, së pari duhet t’ua mohojmë origjinën iliro-epirote-dardane dhe t’ua marrim krenarinë ilire, t’ua shkatërrojmë votrat dhe t’ua ndërrojmë emrat, t’ua njollosim emblemat dhe t’ua fshijmë simbolet e lashta ilire. Dodosdomshëmrisht duhet t’i bëjmë që të bjerrin gjuhën dhe zakonet e tyre dhe njëkohësisht t’a rrëmbejmë gjithçka që kanë të

lashtë ilire e ta përvetësojmë ne.

Duhet t’i lëmë pa miq rreth e rrotull, derisa ata të urrehen e mos durojnë njeni-tjetrin dhe përfundimisht ta mohojnë vetveten. Që të finalizohet kjo platformë, duhet domosdoshmërisht që antishqiptarizmi të jetë filozofia dhe deviza e vetme e shtetit tonë. Mos harroni se mosqenja e Shqiptarëve, është vetë ekzistenca e kombit Serb”!

Në frymën e kësaj platforme të akademikut Çubrilloviq, ka vepruar tërë kohën regjimi serb kundër Shqiptarëve.

Nga dhuna e ushtruar shtetërore, një pjesë e madhe e shqiptarëve janë detyruar të shpërngulen për në Turqi, në Shqipëri apo në shtetet e Perëndimit, ndërsa në tokat e Shqiptarëve ka sjellë kolonistë Serbë, për të ndryshuar strukturën etnike të popullsisë së Kosovës.

Në Luftën e Dytë Botërore Shqiptarët u radhitën në aleancën kundër fashizmit e nacizmit, me shpresë dhe me premtime se pas çlirimit do t’iu lejohet bashkimi me shtetin amë, Shqipërinë, gjë që nuk iu lejua.

Vazhdoi e njëjta politikë e diskriminimit dhe represionit dhe Kosova mbeti e vetmja koloni (e Serbisë) nga të gjitha kolonitë e çliruara prej shteteve koloniste të Europës. Populli Shqiptar kurrë nuk u pajtua me pozitën kolonialiste, diskriminuese që iu imponua, por në mënyra e forma të ndryshme shfaqte paknaqësinë e vet kundër regjimit.

Pas Kushtetutës së RSFJ-së (1974)

Kosova, si krahinë autonome, fitoi statusin e njësisë federale të Jugosllavisë dhe nisi një zhvillim të hovshëm ekonomik, kulturor, arsimor dhe në të gjitha aspektet. Por ky zhvillim i Kosovës dhe përparim i Shqiptarëve e pengonte nacional-shovinizmin klerofashist serb, ashtu që me dhunë policore-ushtarake (1989) e suprimoi atonominë e Kosovës dhe shtriu regjimin e dhunshëm të Serbisë në të gjitha segmentet e jetës politike, shoqërore, ekonomike, arsimore, shëndetësore, kulturore, madje në sporte. Vazhdoi me respresalje brutale kundër shqiptarëve: përjashtimin prej pune, prej shkollave, burgosje, rrahje, vrasje. Serbia ishte okupatore dhe pushteti i saj nuk kishte legjitimitet në Kosovë, pasi ai pushtet nuk kishte përfaqësuesit as pëlqimin e popullit Shqiptar. Lufta çlirimtare e një populli kundër një okupatori, gjithëherë dhe kudo është luftë e drejtë.

Populli Shqiptar i mbledhur rreth LDK-së, si një lëvizje politike gjithëpopullore, u përpoq të bënte një rezistencë paqësore kundër dhunës së regjimit brutal të Serbisë dhe e internacionalizoi problemin, duke kërkuar zgjidhje paqësore për statusin e vet të pavarur, por politika paqësore nuk dha rezultate, veçse gjendja sa vinte keqësohej e më tepër, aq sa zullumi u bë i padurueshëm. U bënë përpjekjet në rrugë diplomatike e juridike për zgjidhje paqësore.

Në këtë frymë, Kuvendi legjitim i Kosovës më 2 korrik miratoi

Deklaratën Kushtetuese për Kosovën Republikë e barabartë me republikat e tjera në kuadër të federatës apo të konfederatës jugosllave, por regjimi i Serbisë e okupoi tërësisht dhe shtriu dhunën mbi institucionet, ndërmarrjet dhe mbi popullin e Kosovës.

Miratimi i Kushtetutës (shtator 1990) dhe Referendumi i mbajtur për pavarësinë e Kosovë (tetor 1991), veçsa i shërbyen si pretekst Serbisë për të shtuar dhunën e represaljet. E ndihmuar nga mediat e regjimit dhe inspiruar nga Kisha Ortodokse Serbe, kundër Shqiptarëve u krijua urrejtje e paparë, që sa vjen e rritet edhe sot 23 vjet pas çlirimit të Kosovës.

Meqë durimi dhe shpresa për zgjidhje paqësore ishin shterrur dhe nuk dhanë rezultate, populli u detyrua t'i çaset edhe metodës të përgjigjes së dhunës me dhunë. Kështu, grupe të caktuara ilegale herë-pas-herë kryenin aksione të armatosura kundër forcave serbe. Ishte kjo shenjë se populli është i vendosur të luftojë për t'u çliruar nga regjimi kolonial gadi njëshekullor i Serbisë. Gradualisht u formua Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila mori mbi vete barrën dhe përgjegjësinë për luftë të armatosur kundër Serbisë, me kauzën e drejtë – për çlirim e bashkim kombëtar.

Kauza e luftës së UÇK-së nuk ishte e re, ajo i ka rrënjët nga Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe Lidhja e Prizrenit (1878), për liri e bashkim kombëtar. Kjo kauzë shihet edhe nga formula e betimit të ushtarëve të UÇK-së, që kishte këtë përmbajtje:

“Si pjesëar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, betohem se:

Do të luftoj për çlirimin e tokave të pushtuara të Shqipërisë dhe për bashkimin e tyre;

Do të jem përherë besnik, luftëtar i denj i lirisë, vigjilent, guximtar dhe i disiplinuar, i gatshëm në çdo kohë, pa kursyer jetën, të luftoj për t'i mbrojtur interesat e shenjta të Atdheut;

Nëse shkeli këtë betim, le të ndëshkohem me ligjet më të ashpra të luftës, dhe nëse tradhtoj – qoftë i humbur gjaku im! Betohejm!”.

Lufta e drejtë për pavarësi e Shqiptarëve në Jugosllavi, e personifikuar tashmë në forcën e saj të armatosur, UÇK-në, e ka mbështetjen e fortë edhe në “Deklaratën e KB mbi dhënien e pavarësisë vendeve dhe popujve kolonialë” (Rezoluta 1514/XVI e Asamblesë së Përgjithshme të KB, 14 dhjetor 1960).

Në pikën 2 të asaj Rezolute thuhet: “Të gjithë popujt kanë të drejtën të vendosin lirisht për fatin e tyre; në bazë të kësaj të drejte, ata përcaktojnë lirisht statusin politik të tyre dhe ndjekin lirisht zhvillimin e tyre ekonomik, shoqëror e kulturor”.

E drejta e vetëvendosjes së popujve, rrjedhimisht lufta e drejtë e UÇK-së, është e përforcuar edhe në dy dokumente tjera paraprake juridike të KB, pikërisht në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturorë



(1966).

Në nenet e para të të dy atyre Pakteve është përcaktuar se “Të gjithë popujt kanë të drejtën e vetëvendosjes. Në bazë të kësaj të drejte, ata e përcaktojnë lirisht statusin e tyre politik dhe sigurojnë në liri zhvillimin e tyre ekonomik, social dhe kulturor”.

Çështja e vetëvendosjes së popujve është definuar edhe në Aktin Final të Helsinkit, në Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (1975).

Në Kapitullin VIII të atij Akti (Barazia dhe vetëvendosja e popujve), në paragrafin e dytë është përcaktuar se: “Në bazë të parimit të barazisë së popujve e të drejtës së tyre për vetëvendosje, të gjithë popujt kanë gjithnjë të drejtën të vendosin në liri të plotë, kur të duan dhe si të duan, statusin e tyre politik të brendshëm e të jashtëm...dhe të vazhdojnë sipas dëshirës së vet zhvillimin e tyre politik, ekonomik, shoqëror e kulturor”.

Ndërsa në Kartën e Parisit të KSBE-së (1990), është garantuar se: “Ne do të sigurojmë që secili (popull,v.j.) të gëzojë të drejtën për të shfrytëzuar mjetet efektive të mbrojtjes juridike kombëtare ose ndërkombëtare kundër çdo shkelje të të drejtave të tij”. Lufta e UÇK-së për çlirim, pavarësi e vetëvendosje bëhej në bazë të këtyre parimeve të akteve ndërkombëtare, dhe asnjë mendje e shëndshë nuk mund të mohojë atë se ka qenë luftë të drejtë.

Përkrah numri, Shqiptarët ishin kombi i tretë në ish-Jugosllavi (pas Serbëve dhe Kroatëve), por iu mohoj statusi i kombit dhe për ta kishin shpikur një term “kombësi”, për t’ua mohuar të drejtën e vetëvendosjes, të cilën e kishin kombet tjera shumë më të vogla (malazezët, maqedonët).

Se lufta e UÇK-së ishte luftë e drejtë kundër agresionit të Serbisë në Kosovë, vërtetohet edhe me vetë intervenimin e NATO-s, në ndihmë UÇK-së, në mbështetje të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Po të mos ishte e drejtë lufta e UÇK-së, NATO si aleancë e shteteve më demokratike nuk do të radhitej përkrah saj.

Nga çfarëdo aspekti që të marrësh, lufta e UÇK-së për çlirimin e vendit dhe të popullit nga okupimi serb ishte luftë e drejtë. Si rezultat i asaj lufte të drejtë, erdhi çlirimi dhe formimi i shtetit të Kosovës, të cilin e njohën shumica e vendeve

më demokratike të botës dhe e njohu edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, e cila vërtetoi se me shpalljen e pavarësisë, Kosova nuk ka shkelur asnjë parim ose normë të së drejtës ndërkombëtare, madje as Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB 1244.

### A ishte e pastër Lufta e UÇK-së

Çështja e pastërtisë së luftës nuk është objekt rregullimi i të drejtës së luftës, respektivisht të konfliktit të armatosur. Kjo çështje i takon të drejtës ndërkombëtare humanitare, e cila parasheh mbrojtjen e kategorive të caktuara të njerëzve, të objekteve, të infrastrukturës e të tjera, në rastet e konflikteve të armatosura.

Për këtë ekzistojnë katër konventa të Gjenevës (1949) dhe protokollet shtesë të tyre: 1) Konventa për të Plagosurit dhe të Sëmurët e Forcave të Armatosura Tokësore; 2) Konventa...për të Sëmurët dhe të Plagosurit në Anijet e Përmbytura të Forcave Detare; 3) Konventa për Trajtimin e të Burgosurve të Luftës; dhe 4) Konventa për Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Luftë.

Të gjitha ato konventa mbajnë datën 12 gusht 1949, dhe të gjitha i obligojnë palët nënshkruese (nënshkruese ka qenë edhe Jugosllavia), që gjithëherë dhe në çdo rast të respektojnë rregullat e të drejtës humanitare, pavarësisht se a i respekton ato pala kundërshtare ose jo. Në këtë aspekt nuk vlenë parimi i reciprocitetit. Dhe këto parashohin përgjegjësinë e individëve për shkeljen e rëndë të normave të kësaj të drejte, si për rastet e luftës midis shteteve ashtu edhe për konfliktet e brendshme.

Në dispozitat e përbashkëta të të katër konventave parashihen sanksione penale për shkeljen e konventave. Për konfliktin e armatosur të karakterit jondërkombëtar, që ndodh në territorin e njëres paë (të konventës, v.j.), secila nga palët në konflikt është e detyruar të zbatojë të paktën dispozitat që vijojnë:

“1. Personat që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në luftime, bashkë me forcat e armatosura që kanë dorëzuar armët dhe janë nxjerrë jashtë luftimit për shkak plagosje, zënie rob, sëmundje ose për çdo shkak tjetër, - në të gjitha rrethanat

duhet të trajtohen njerëzisht, pa asnjë dallim rece, ngjyre, feje ose besimi, seksi, lindjeje ose pasurije apo çdo kriteri tjetër analog.

Kundër personave të kategorive të lartpërmendura janë të ndaluara, në çdo kohë e në çdo vend:

dhunimi kundra jetës ose tërësisë trupore, sidomos vrasja në të gjitha format, gjymtimet, trajtimet mizore, torturat dhe ndëshkimet; marrja e pengjëve; cënimi kundra dinjitetit personal, sidomos trajtimet poshtëruese dhe çnjerezore;

dënmjet e dhëna dhe ekzekutimet e bëra pa një gjykim paraprak të dhënë prej një gjykate të formuar rregullisht dhe të veshur me ato garanci gjyqësore që janë njohur si të domosdoshme prej gjithë popujve të qytetëruar.

2. Të plagosurit dhe të sëmurët do të mbldhen dhe do të kurohen.

Se si kanë vepruar forcat serbe ndaj civilëve shqiptarë – dihet botërisht. Ato kanë vrarë, masakruar e djegur për së gjallë civilët të cilët fare nuk kanë qenë të armatosur as të involvuar në luftë. Nuk kanë kursyer as gjini as moshë. Në mesin e të vrarëve e masakruarëve të tillë kanë qenë edhe 1400 fëmijë, ndërsa janë dhunuar mbi 20 mijë femra, disa prej të cilave i kanë vrarë pas dhunimit.

Të mos e përmendim plaçkitjet e gjithçka që kishte vlerë dhe që mund ta lëviznin, ndërsa shtëpitë ua digjin, shpeshherë me familjarë brenda!

Por, në kontekst të të drejtës humanitare të konventave të përmendura, ai barbarizëm i forcave serbe, nuk i justifikon krimet eventuale që mund t'i kenë kryer individë të prirur për krime edhe nga radhët e UÇK-së, ndaj personave të palës tjetër, sepse është vështirë të përmbahen kur shohin e dëgjojnë se çfarë kanë bërë forcat serbe ndaj të afërmeve të tyre apo përgjithësisht ndaj civilëve shqiptarë.

Duhet konstatuar e pranuar këtu, se asnjëra palë e konfliktit të armatosur, pas atij konflikti, nuk i ka proceduar fajtorët e krimeve të kryera nga radhët e forcave të veta. Përkundrazi, në Serbi krimelët e tillë janë trajtuar si heronjë e janë avancuar në pozita shtetërore. Tribunali i Hagës i ka gjykuar një numër të vogël për krime të tilla. Nuk mund të thuhet me siguri të plotë se edhe nga individë të

caktuar, pjesëtarë të UÇK-së, nuk ka pasur shkelje të dispozitave humanitare në kuptimin e konventave të përmendura më sipër.

As gjykatat e UNMI-ut e të EULEX-it, as gjykatat vendore të Kosovës nuk e kanë dhënë provimin për procesimin e personave të dyshuar apo të akuzuar për vepra kriminale nga konflikti i armatosur. Prandaj, bashkësia ndërkombëtare insistoi të formohet një gjykatë speciale për procesimin e pesonave të dyshuar.

Gjykata edhe pse quhet se është Gjykatë Speciale e Kosovës, ajo nuk ka të bëjë asgjë me sistemin gjyqësor të Kosovës, selinë e ka në Hagë, të gjitha instancat gjyqësore janë në kuadër të saj, kurse gjykatësit dhe prokurorët janë të gjithë të huaj, pa asnjë shqiptar. Absurdi më i madh është se gjykata është themeluar për gjykime njëetnike, vetëm të shqiptarëve.

Absurdi tjetër është se edhe pse është speciale për gjykime të periudhës së luftës, kompetencën e vet e ka shtrirë prej 1 janar 1998 deri më 31 dhjetor 2000, e dihet se lufta ka përfunduar më 10 qershor 1999, me nënshkrimin e Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake në Kumanovë, dhe se UÇK-ja është shpërbërë në qershor të atij viti.

Përshtypja është se ajo gjykatë do të gjykojë në bazë të gënjeshtreve të Sigurimit dhe të Prokurorisë së Serbisë, të grumbulluara e dërguara Gjykatës, në formë të “provave me shkrim e me fotografi”, dhe në bazë të dëshmimeve të dëshmitarëve të përgatitur prej atyre organeve, qofshin ata si “viktima” apo si dëshmitarë të akuzës.

Fundja, ajo Gjykatë u themelua në bazë të raportit të Dick Martit, i përpiluar kryekput në bazë të shpifjeve dhe gënjeshtreve të organeve të Serbisë, gjoja për nxjerrjen dhe trafikimin e organeve, për të cilat nuk janë gjetur prova përkundër hetimeve të thella që dhjetë vjet që janë bërë nga organet hetuese ndërkombëtare.

Prandaj, jemi skeptik se Gjykata Speciale do mund të gjykojë drejtë, as personat të cilët gjenden aktualisht në proces, as të tjerët që do t'i procesuojë pas tyre.

Sidoqoftë, përgjegjësia është individuale dhe çfarëdo vendimesh të merrë Gjykata Speciale, nuk do të mund ta njollosë pastërinë e luftës së UÇK-së. Sepse lufta e UÇK-së ka qenë luftë e pastër, luftë çlirimtare, me kauzë të qartë.

UÇK nuk ka vrarë e masakruar as fëmijë as gra civile serbe. Vrasja e fëmijëve dhe grave është në kundërshtim të repte me traditën dhe etikën shqiptare.

Nga ana tjetër, civilët serbë të gjithë kanë qenë të armatosur, shteti iu ka dhënë armët, prandaj edhe nëse nuk kanë qenë të mobilizuar apo vullnetarë në formacionet ushtarake, policore e paraushtarake, ata në një mënyrë kanë qenë bashkëpunëtorë të ngushtë të forcave serbe kundër UÇK-së.

# Kush ishte Karli i Madh, perandori që u quajt “babai” i Evropës?



**Nga Emily STANIFORTH**

Karli i Madh sundoi mbi perandorinë e madhe Karolingiane që shtrihej në Evropë gjatë Mesjetës së Errët. Ai u bë mbret i Frankëve në vitin 768 pas Krishtit dhe gjatë mbretërimit të tij 46-vjeçar pushtoi pjesën më të madhe të Evropës. Në këtë mënyrë ai hodhi themelet për Perandorinë e Shenjtë Romake, e cila do të ekzistonte për gati 1 mijë vite.

Po ashtu ai krijoi një lloj të ri udhëheqjeje mbretërore, që do të frymëzonte shumë breza monarkësh evropianë. “Karli i Madh ishte një model për mbretërit edhe shumë shekuj pas vdekjes së tij, dhe perandoria e tij përfaqësonte idealin më të lartë të qeverisjes në shekullin XIX” - thotë Majkëll Fraseto, lektor i historisë në Universitetin e Delauerit.

Karli i Madh e mbrojti reformën fetare dhe ruajti një marrëdhënie të ngushtë me papët në Romë. Po ashtu ai mundësoi Rilindjen Karolinge, duke investuar në ngritjen e manastireve dhe katedraleve dhe duke nxitur një rilindje në aspektin e të mësuarit. Për pasojë, në kryeqytetin e tij, Ahen (Gjermania e sotme) lulëzoi si arsimit po ashtu edhe feja.

Sot Karli i Madh kujtohet si “Babai i Evropës” për shkak të bashkimit nën sundimin e tij të pjesës më të madhe të kontinentit. Në fundin e shekullit IV dhe fillimin e shekullit V, ndikimi i Perandorisë Romake ra së tepërmi në Evropën Perëndimore, teksa fiset gjermanike sulmuan dhe

shkatërruan Romën, duke sjellë rënien e Perandorisë Romake Perëndimore në vitin 476.

Nga ai vakum pushteti përfituan një sërë fisesh frankë që ishin vendosur në Gali (Francën e sotme), të cilat e konsoliduan sundimin e tyre nën një sërë mbretërisht. Nga këto fise frankelindi dinastia Merovingiane (mesi i shekullit V deri në vitin 751). Por në shekullin VII, mbretërit Merovingianë kishin pak pushtet.

Territoret frankë ishin rrallëherë të bashkuara nën një sundimtar dhe luftimet e brendshme ishin të shfrenuara. Sharli Martel, gjyshi i Karlit të Madh, nisi të dominojë politikisht në anën lindore dhe perëndimore të mbretërisë, duke filluar uzurpimin ngadalë të vendit të merovingëve në favor të dinastisë së sapolindur Karolinge, thotë historiania e Mesjetës së Hershme Xhenifer R.Dejvis, profesore e asociuar i historisë në Universitetin Katolik të Amerikës në Uashington.

“Ishte babai i Karlit të Madh që në fund e rrëzoi dinastinë Merovingiane dhe e shpalli veten mbret në vitin 751. Historiografia Karolinge i kushtoi jo pak vëmendje denigrimit të Merovingëve dhe justifikimit të atij që në thelb ishte një grusht shteti” - thekson Dejvis.

Pepin Shkurtabiqi, babai i Karlit të Madh, pretendoi se kishte marrë miratimin e Papës për rrëzimin e Merovingëve, edhe pse këtë e dëshmojnë vetëm burimet frankë. Gjithsesi, burimet frankë dhe papale vunë në dukje se në vitin 753 Papa Stefani II udhëtoi për herë të

parë në shtetet frankë dhe formoi një aleancë.

Ai deklaroi se mbretërit frankë duhet të zgjidheshin vetëm nga dinastia Karolingiane, ndërsa në këmbim të kësaj mbështetjeje, frankët do të mbështesnin interesat territoriale të papatit kundër presionit nga lombardët në Itali. Po kush ishte Karli i Madh? Ai lindi rreth vitit 742.

Pas vdekjes së Karlit të Madh në vitin, studiuesi frank Einhard, që ishte bashkëkohës dhe kishte shërbyer në oborrin e tij, shkroi se dihej pak mbi fëmijërinë dhe vitet e rinisë së hershme.

“Gjithsesi e sigurt është që arsimimi i tij i hershëm, nuk përfshinte shumë lexime apo shkrime. Ai nuk mësoi të shkruante, ndaj mezi i firmoste dokumentet e tij” - thotë Albreht Klasi, profesor i studimeve gjermanike në Universitetin e Arizonës, SHBA. Karli i Madh trashëgoi gjysmën e mbretërisë së babait të tij pas vdekjes së këtij të fundit në vitin 768. Vëllai i Karlit të Madh, Karlomani, trashëgoi gjysmën lindore. Dy mbretërit frankë kishin një marrëdhënie të çuditshme dhe shpeshherë konfliktuale. Në vitin 771, vdekja e parakohshme e Karlomani e shpëtoi mbretërinë nga lufta civile dhe i dha Karlit të Madh dominimin mbi të gjitha territoret frankë, shkruan Fransu Ganshof, historian belg i epokës së Mesjetës në librin “Karli i Madh”.

Gati menjëherë pasi u bë mbreti i Frankëve, Karli i Madh nisi një fushatë për të siguruar territoret e tij nga lakmia e forcave fqinje që përpiqeshin vazhdimisht të depërtonin në territorin frank. Kështu Karli i Madh filloi një luftë të gjatë dhe të përgjakshme

kundër Saksonëve, një fis tjetër gjerman.

Në vitin 772, ushtria e Karlit të Madh marshoi në Saksoni (sot Gjermania Veriore), duke vendosur aty një prani të përhershme ushtarake në një kufi të fortifikuar. Karli i Madh e përdori atë zgjerim territori si një mundësi për të përhapur krishterimin në një zonë tradicionalisht pagane të Evropës.

Krishterimi i Saksonëve nga Karli i Madh ishte një sukses personal për perandorin. Gjatë luftës 10-vjeçare në Saksoni, ekspansioni ushtarak i Karlit të Madh vazhdoi në zona të tjera të Evropës. Në 774, sulmi dhe mposhtja e mbretërisë Lombarde në Italinë Veriore, solli kurorëzimin e tij atje.

Në vitin 788, pushtoi Bavarinë, duke e aneksuar në mbretërinë e tij. Për të ruajtur rendin mbi një territor aq të madh, Karli i Madh ndërtoi një organizatë të sofistikuar administrative. Po ashtu ai përdori edhe strukturat brenda kishës.

“Peshkopët, priftërinjtë ose dhjakët nuk ishin domosdoshmërisht të interesuar për pushtetin laik. Por ata ishin të arsimuar dhe u mbështetën nga Karli i Madh, që i përdori si administratorë të klasit të parë në të gjithë vendin e tij” - thotë Klasi.

Por Karli i Madh nuk hezitoi të përdorte dhunën kundër rebelëve. Në luftën e tij ndaj Saksonisë, ai kreu masakra kundër atyre që po përpiqej të pushtonte. Si për shembull në vitin 782 me Masakrën e Verdunit, ku thuhet se urdhëroi vrasjen e rreth 4500 saksonëve.


Nga ana tjetër, Karli i Madh i lejoi popullatat që pushtoi që të

funksiononin kryesisht siç kishin bërë më parë. “Në përgjithësi ai nuk ua mori gjithë tokat aristokracisë vendase. Por nëse dikush rebelohej, atëherë toka i merrej dhe i jepej dikujt tjetër” - shprehet Dejvis.

Marrëdhënia e Karlit të Madh me kishën ishte shumë e fortë gjatë gjithë jetës së tij. Karli i Madh ndërtoi manastire dhe katedrale në të gjithë territoret e tij dhe ashtu si i ati para tij, i ofroi mbrojtje Papës në këmbim të patronazhit të tij të vazhdueshëm. Kjo marrëdhënie simbiotike bëri që Karli i Madh të shpallej perandori romakëve, duke e bërë atë personin e parë që mbante këtë titull që nga rënia e Perandorisë Romake Perëndimore.

Thuhet se kurorëzimi ishte një shpërblim për ndërhyrjen e Karlit të Madh në shpëtimin e Papa Leonit III. Në vitin 799, Papa shkoi në oborrin e Karlit të Madh pasi u verbua në rrugë. Karli i Madh organizoi kthimin e sigurt të Papës në Romë. Në vitin 800, Karli i Madh udhëtoi vetë për në Romë dhe e detyroi Papa Leonin III të betohej publikisht për të hequr akuzat për sjellje të pahijshme të ngritura kundër tij nga kundërshtarët.

Ditën e Krishtlindjes së vitit 800, Papa Leoni III e falënderoi Karlin e Madh duke e bekuar si perandor. Më vonë ky titull do të evoluonte në Udhëheqës i Perandorisë së Shenjtë Romake. Karli i Madh vdiq në vitin 814 në moshën 72-vjeçare dhe ia la fronin djalit të tij, Luigjit të Devotshëm. Mbreti frank frymëzoi udhëheqësit e ardhshëm, si Napoleon Bonapartin, që e pa mbretërimin e Karlit të Madh si një shembull ideal të imperializmit. /“Livescience” – Bota.al



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Argjentina fiton Kupën e Botës

### "Epoka e re"

**DOHA, 18 DHJETOR** - Argjentina e Leo Messit e ka fituar Kupën e Botës 2022 të zhvilluar në Katar. Këtë sukses argjentinasi e arritën për herë të tretë në histori të tyre, derisa Messi realizoi ëndërrën jetësore që të fiton Botërorin me Kombëtaren e Argjentinës. Në finalen e madhe, argjentinasi triumfoi pas penalltive (4-2), pasi koha e rregullt dhe vazhdimet përfunduan me rezultat të barabartë 3-3. Kjo finale ishte mjaftë e bukur dhe me shumë kthesa në rezultat. Argjentina shënoi dy gola në pjesën e parë, Messi nga penalltia dhe Di Maria. Franca edhe përkundër asaj që kishte pak raste shënimi arriti të rikthehet në lojë në minutën e 79-të, kur Mbappe shënoi gol nga penalltia. Sulmuesi francez realizoi pas një minute edhe golin e dytë për rezultatin 2-2. Koha e rregullt përfundoi me këtë rezultat, kurse në vazhdimet u shënuan edhe dy gola të tjerë. Në minutën e 109-të, Messi e riktheu epërsinë e Argjentinës duke shënuar nga afërsia, por Franca sërish e barazoi rezultatin me Mbappen, i cili shënoi nga pika e bardhë në minutën e 117-të. Nga

goditjet e penalltive, Argjentina ishte më e saktë, duke shënuar katër herë, kurse Franca shënoi dy herë nga katër gjuajtje. Lionel Messi fitoi më në fund trofeun e Kupës së Botës me Argjentinën. Pasi ngriti në qiell Kupën e Botës, Messi përpara mediave tregoi emocionet e tij. "Është një çmenduri, e kërkuam shumë dhe është gjëja më e bukur që ekziston. E doja shumë. E dija që Zoti do të ma jepte, kisha një ndjesi të tillë. Vuajtëm shumë, por në fund ia dolëm. Mezi po pres të kthehem në Argjentinë për të parë se çfarë çmendurie kemi bërë. Është e qartë që doja ta mbyllja karrierën me këtë trofe, nuk mund të kërkoj më asgjë. Falënderoj Zotin që më dha gjithçka. Pothuajse të mbyll karrierën time kështu është e jashtëzakonshme. Çfarë do të ndodhë më pas? Ia kam dalë të fitoj Kupën e Amerikës, Kupën e Botës. E dashuroj futbollin dhe atë që bëj. Më pëlqen të luaj me Kombëtaren, me këtë grup, dua të vazhdoj të jetoj edhe disa ndeshje si kampion bote. Është ëndrra e çdo fëmije. Kam qenë me fat që i kam fituar të gjitha dhe e vetmja gjë që më mungonte ishte kjo", ka thënë Messi.



### ÇMIMET E DHËNA PËR LOJTARËT NË KATAR 2022:

**I riu më i mirë - Enzo Fernandez (Argjentinë)**  
**Portieri më i mirë - Emiliano Martinez (Argjentinë)**  
**Golashënuesi më i mirë - Kylian Mbappe (Francë)**  
**Futbollisti më i mirë - Lionel Messi (Argjentinë)**

## Fitorja e nëntë radhazi për kampionin, 'xehetarët' mundin kuqezinjtë

**PRIZREN, 18 DHJETOR** - Golden Eagle Ylli ka vazhduar me fitore, që ishte e nënta radhazi. Në një ndeshje shumë interesante, kampionët pas vazhdimëve kanë mundur Bashkimin në Prizren me rezultat 78:80 (22:21, 17:24, 21:10, 13:18, 5:7), në xhiron e 14-të të Prince Caffè Superligës. Në çerekun e parë ndeshja ishte shumë e barabartë, ku asnjëra nuk arrinte të shkapëtej dhe përfundon 22:21. Vendasit kishin gjashtë pikë epërsi në periudhën e dytë, 35:29, por më pas therandasit me një seri të jashtëzakonshme përmbyesën rezultatin në 35:40, kurse pjesa e parë përfundoi 39:45. Prizrenasi e nisën më mirë



pjesën e dytë, përkatësisht periudhën e tretë, duke e kthyer epërsinë në favor të tyre, ku shifrat pas 30 minutash ishin 60:55. Vendasit dy minuta nga fundi ishin në epërsi 73:69, por

nuk e ruajtën epërsinë dhe Davis në fund nga gjuajtjet barazoi rezultatin në 73:73, duke e dërguar ndeshjen në vazhdimet. E, në vazhdimet po ashtu ishte sfidë interesante, ku Ardit Pepaj

shënoi në sekondat e fundit për 78:80. Ylli ka nëntë fitore e katër humbje, kurse prizrenasi katër fitore e dhjetë humbje. Më i miri te Bashkimi ishte Daniel Lekndreaj me 21 pikë e 13 kërcime, kurse te Ylli më i miri ishte Henrik Sirko me 18 pikë e 12 kërcime. Trepça shënoi fitore ndaj Vëllaznimit me rezultat 88:72 (29:29, 28:12, 13:18, 18:13), në xhiron e 14-të të Prince Caffè Superligës. Në çerekun e parë mysafirët kishin epërsi prej 5-6 pikësh, që u mbyll me barazim 29:29. Por, periudha e dytë ishte vendimtare e kësaj sfidë. Mitrovicasit ishin të jashtëzakonshëm në këtë pjesë

dhe ngritën epërsinë minutë pas minute, ndërsa shkuan në pushim me rezultat 57:41. Pjesa e dytë ishte e barabartë, por që vendasve nuk ju rrezikua fitorja. Perioda e tretë përfundoi 13:18, ndërsa ajo e fundit 18:13, për fitoren e Trepçës 88:72. Te vendasit më të mirët ishin Ken Brown me 16 pikë, katër kërcime e pesë asistime dhe Erjon Kastrati me 18 pikë, pesë kërcime e gjashtë asistime, kurse te mysafirët u dalluan Jordan Harris me 22 pikë dhe Atik Koshi me 16 pikë, tri kërcime e katër asistime. 'Xehetarët' kanë shtatë fitore e shtatë humbje, kurse kuqezinjtë gjashtë fitore e tetë humbje.

## Rahoveci me fitore bindëse ndaj Deçanit

**RAHOVEC, 18 DHJETOR** - Rahoveci ka shënuar fitore bindëse në kuadër të xhiros së 13-të të Superligës së Kosovës në hendboll. Të dielën mbrëma në Rahovec, "vreshtarët" fituan ndaj Deçanit me rezultat 32:24. Vendasit në pjesën e parë ishin në epërsi të vazhdueshme, që shkoj deri në tetë gola, 16:8.

Tjetër rrjetë kishte pjesa e dytë. Deçanasi u afruan deri në 21:20, në minutën e 47-të. Por më pas vendasit realizuan seri tjetër për t'u shkëputur sërish në rezultat. Epërsia shkoj deri në tetë gola, 30:22, ndërsa në fund rezultati ishte 32:24. Alban Haziri i shënoi 10 gola për Rahovecin. Shtatë i kishte Çlirim Rama, ndërsa

gjashtë i realizoi Marley De Carvalho Fernandez. Tetë gola për Deçanin i shënoi Alex Fabricio De Abreu Santos. Nga tri i kishin Albion Loshaj, Fatlind Mazrekaj dhe Felipe Porto. Në xhiron e 14-të, të fundit për stinorin vjeshtor, Rahoveci luan në udhëtim me Trepçën, ndërsa Deçani e pret Prishtinën.







ROYAL CROWN



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

